

**Pyetjet dhe përgjigjet nga Takimi Orientues (webinar), i zhvilluar më 23 Korrik, ora 10:00, në kuadër të thirrjes për projekt propozime nga projekti ideAL.**

1. *Kush mund të aplikojë?*

Lejohen të aplikojnë:

(1) Persona juridik (organizata), ose persona natyror (individë);

(2) Në rastin e një personi juridik:

- Të jetë një organizatë e shoqërisë civile, jo-fitimprurëse, e regjistruar si një OJF, sipas legjislacionit shqiptar për [organizatat jofitimprurëse](#)

- Të jetë themeluar dhe të operojë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

(3) Në çdo rast, të jetë pa precedent ligjor në veprimtari mashtrimi apo korrupsioni.

(4) Në çdo rast, të mos jetë përfshirë në veprimtari fetare;

(5) Të mos jetë grupim/parti/entitet politik;

Mirëpritën aplikime nga:

- organizata të shoqërisë civile,

- think tanks,

- institute kërkimore,

- shoqata, unione, apo entitete të ngjashme

- studiues të pavarur,

- ekspertë të fushave të ndryshme të angazhuar në procese hulumtimi të politikave publike në Shqipëri,

- aktivistë,

- analistë,

- gazetarë që mbulojnë tema/çështje në ciklin e politikave,

- akademikë, etj

2. *Mund të aplikojmë për nën fusha të fushave prioritare?*

Po, përsa kohë këto aspekte kanë lidhje me objektivin e thirrjes dhe e bëjnë të qartë në cilën fazë të ciklit të politikave qëndron propozimi, dhe përmbush të gjitha kriteret e parashikuara në këtë thirrje, përfshirë objektivin dhe kushtet e lejueshmërisë.

3. *A ka afat kohor për ekzistencën historike të organizatës?*

Jo, nuk ka kufizim. Inkurajojmë projekt propozime nga të gjitha organizatat dhe individët, të cilët kanë përvojë/interes kërkimor në fushën e hulumtimit dhe ndikimit të politikëbërjes.

4. *Nëse kemi të përfshirë në organizatë një kërkues dhe ai person do të aplikojë edhe i vetëm në këtë thirrje a është e lejueshme?*

Në përputhje me kushtin e thirrjes, një aplikant (organizatë apo individ) mund të marrë pjesë vetëm përmes 1 projekt propozimi.

5. *Në një situatë të tillë pandemie, a është vlerë e shtuar në aplikim të parashikohet një contingency plan nëse kemi një fazë tjetër lock-down?*

COVID 19 është pjesë e realitetit, nga ku e ka pikënisjen dhe thirrja. Në këto kushte, sikurse shpjegohet dhe në dokumentin udhëzues të thirrjes, aplikantët inkurajohen ta marrin parasysh këtë fakt kur hartojnë planin e aktiviteteve. Kjo nuk do të thotë që duhet të planifikojmë për skenare ekstreme, por, që plani të lejojë mjaftueshëm fleksibilitet dhe mundësi për përshtatje në rast përsëritje të masave shtrënguese. Ndaj, parashikimi i një *contingency plan të mirëfilltë*, nuk përbën domosdoshmërisht vlerë të shtuar, apo kusht të detyrueshëm.



6. *Cilën periudhë (datë) duhet të kemi parasysh për fillimin e aktiviteteve?*

Në përputhje dhe me *kalendarin e parashikuar, në dokumentin e thirrjes*, ne parashikojmë të kemi përmbyllur procesin e kontraktimit me projektet fituese Brenda javës së 1rë të muajit nëntor. Ndaj mesi muajit nëntor mund të shihet si fillimi i aktiviteteve, por ju këshillojmë të parashikoni aktivitetet tuaja duke përdorur Muaji 1, Muaji 2.....Muaji n, sikurse dhe e gjeni në planin e aktiviteteve, pjesë e Shtojca A.

7. *Sa përqind e buxhetit është e destinuar për staff, apo nuk ka kufizime?*

Nuk ka një kufizim, por përsa kohë ju kërkohet të keni aktivitete që kërkojnë të përmbushin disa kriteret, rrjedhimisht i gjithë buxheti nuk mund të alokohet për staf.

8. *Ka një kufizim për të marrë pjesë në Lotin 1?*

Nuk lejohen individë/ persona natyrorë.

9. *Mund të mbajmë aktivitete të cilat kanë efekte apo benefite në stakeholders të ndryshëm, ato të cilat përfshijnë nxitjen e punësimit të grave/të rinjve?*

Thirrja ka në fokus hulumtimin dhe ndikimin në nivel politikëbërje. Si e tillë, aktivitetet duhet të lidhen me aktorët shtetërorë dhe të jenë të formave që garantojnë arritjen e objektivave dhe impaktit. Për t'ju ardhur në ndihmë ne kemi përfshirë disa grafika ilustruese në dokumentin udhëzues të thirrjes, dhe disa pyetje. Në këtë kuadër, që të jeni në linjë me objektivin e thirrjes dhe kushtet e lejueshmërisë, ju mund të fokusoheni në nxitjen e punësimit të grave dhe të rinjve, por përmes ndërhyrjeve që synojnë përmirësimin e politikave ekzistuese, apo propozimit të nismave të reja, gjithmonë në nivel politik-bërje.

10. *A mund të jetë një pikënisje nga pushteti vendor?*

Thuajse çdo çështje ka një dimension shumë të forte lokal, për sa kohë prek një grup apo komunitet të caktuar. Por, aktivitetet duhet me deomos të jenë të ankoruara fort dhe qartë në ciklin e politikave, duke specifikuar mire fazën ku ka zanafillën pikënisja e ndërhyrjes së propozuar, dhe cilat janë minimalisht dy fazat që do të përshkrohen.

11. *Si do të dorëzohet aplikimi?*

Aplikimi do të kryhet elektronikisht në adresën: [co-plan@co-plan.org](mailto:co-plan@co-plan.org). Një email konfirmues do t'i dërgohet çdo aplikanti për të konfirmuar marrjen e aplikimit.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është *data 11 Shtator 2020*, brenda orës 17:00. Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit të përcaktuar do të refuzohet automatikisht

